



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORATI QENDROR

UDHËZIM

Nr. 65 , datë 19/09/2014

PËR

“BASHKËRENDIMIN NË MONITORIMIN E ZBATIMIT TË LIGJIT PËR MBROJTJEN E SHËNDETIT NGA PRODUKTET E DUHANIT, NGA TRUPAT INSPEKTUESE”

Në zbatim të Ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM nr. 696, datë 16.08.2013, “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”, të Ligjit Nr. 76/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9636, datë 06.11.2006, “ Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar;

UDHËZOJ:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Hyrje

Misioni i Inspektoratit Qendror është përmirësimi i efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Për arritjen e misionit të tij Inspektorati Qendror bashkërendon veprimtarinë e inspektorateve shtetërore e vendore, si dhe të trupave inspektuese duke mbikëqyrur zbatimin e Ligjit nr. 10433,

datë 16.06.2011, “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të legjislacionit të zbatueshëm sektorial, nga inspektoratet shtetërore/vendore.

Qëllimi i veprimtarisë së inspektimit, është krijimi i një mjedisi të përgjithshëm rregullator ligjor, jo vetëm për të rritur transparencën dhe mbështetje në veprimtarinë e trupave inspektuese, por për të garantuar sigurinë në mbrojtjen të shëndetit publik.

Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në zbatim të ligjit nr. 76/2014, Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9636, datë 06.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, të ndryshuar, janë përcaktuar edhe institucionet përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, si vijon:

- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
- Inspektorati Shtetëror i Arsimit;
- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore;
- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit;
- Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe e Shpëtimit.

II. PROGRAMIMI I INSPEKTIMEVE

Gjatë veprimtarisë së tyre inspektuese, inspektoratet shtetërore/ trupat inspektuese përgjegjëse, në programet e tyre inspektuese, përveç mbikëqyrjes së zbatimit të legjislacionit të tyre sektorial, gjatë ushtrimit të kontrollit, duhet të mbikëqyrin edhe zbatimin e Ligjit Nr. 76/2014.

2.1 Zbatimi i ligjit nr.76/2014, duhet të jetë një proces mbikëqyrës inspektimi i vazhdueshëm nga inspektoratet shtetërore përgjegjëse, si dhe trupat inspektuese të cilat duhet të marrin masat që në programimin e inspektimeve të tyre të mbikëqyrjet përveç përmbushjes së kërkesave të legjislacionit të tyre sektorial, edhe zbatimi i këtij ligji, ku në programet vjetore dhe mujore të punës së këtyre inspektorateve të shtohet në listat e verifikimit të tyre, edhe verifikimi i zbatimit të këtij ligji si rubrikë më vehte.

III. MBIKËQYRJA E ZBATIMIT TË LIGJIT

3.1 Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr. 76/2014, duhet të jetë objekt kontrolli i programeve të inspektimeve nga të gjitha institucionet përgjegjëse për kontrollin e zbatimit të këtij ligji, në të gjitha mjediset ku ndalohet pirja e duhanit.

3.2 Trupat inspektuese të bëjnë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore që burojnë nga ky ligj, në përputhje me Ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

3.3 Nëse gjatë veprimtarisë inspektuese identifikohen subjekte, të cilat nuk kanë marrë masat e nevojshme për zbatimin e këtij ligji dhe që paraqesin një mundësi reale më të madhe për moszbatimin, ose një zbatim preferencial të ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, trupat inspektuese duhet të njoftojnë menjëherë me shkrim Inspektoratin Qendror, i cili me marrjen e këtij njoftimi ja përcjell atë inspektoratit kompetent.

3.4 Inspektorati Qendror, si institucion përgjegjës për bashkërendimin e veprimtarisë së trupave inspektuese për zbatimin e Ligjit Nr. 76/2014, në mbikëqyrjen e veprimtarisë së inspektorateve shtetërore/vendore, për zbatimin e legjislacionit në fuqi për inspektimin, do të ketë objekt të mbikëqyrjes së saj jo vetëm respektimin e procedurave inspektuese, në përmbushje të legjislacionit të posaçëm sipas fushës së inspektimit dhe akteve nënligjore që rrjedhin prej tyre, por edhe monitorimin e zbatimit të Ligjit Nr. 76/2014, si efekt i këtij Udhëzimi.

Ky Udhëzim botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

ILIR ZELA

